



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 2956/prot.

Tiranë, më 05.04.2019

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1814, datë 04.08.2016.

SHOQËRISË “GENER 2” SH.P.K
Alba Business Center, Floor 7, Rr. “Papa Gjon Pali II-të”, Tiranë.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT
NË MINIERA
Rr. “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “Gener 2” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1814, datë 04.08.2016, e ndryshuar me nr.akti 2523/2, datë 29.05.2018, duke u emërtuar 1814/1 datë 04.08.2016, dhënë për mineral gur gëlqeror, në objektin “Gjergjovë”, Skrapar, Qarku Berat.

Leja nr.1814, datë 04.08.2016 është dhënë mbështetur në bazën ligjore, për veprimtarinë minerare, si karrierë për qëllime publike vendore ose kombëtare, ku në pikat 1 dhe 4, të nenit 23, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, thuhet:

“1. Njësitë e qeverisjes vendore ose institucioni, i cili menaxhon projekte me rëndësi kombëtare, mund t’i propozojnë ministrit miratimin e zonave minerare - karriera, për t’u shfrytëzuar për qëllime publike vendore ose kombëtare, në sipërfaqet në pronësi të njësisë përkatëse”.....

“4. Leja e shfrytëzimit të karrieraeve për qëllime publike vendore ose kombëtare ka afat vlefshmërie jo më shumë se 3 vjet, me të drejtë rinovimi për një vit, sipas kërkesës së zotëruesit, e cila duhet të paraqitet, së paku, 30 ditë kalendarike përpara datës së mbarimit të lejes së mëparshme”.

Me shkresën e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) nr.707/2, datë 07.03.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë nr.2956, datë 11.03.2019, është dërguar Vendimi i Këshillit Teknik nr.715, datë 27.02.2019, “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e procedurave të mbylljes së zonës 56/6, për mineral gur gëlqeror, objekti “Gjergjovë”, Skrapar, e lejes minerare nr.1814, datë 04.08.2016, të subjektit “Gener 2” sh.p.k.

Vendimi është marrë bazuar në kërkesën e shoqërisë tuaj “Njoftim për fillimin e procedurave të mbylljes së lejes minerare nr.1814, datë 04.08.2016, në objektin “Gjergjovë”, Skrapar, drejtuar AKBN-së.

Kërkesa juaj është e bazuar në germën “a”, të pikës nr.2, të nenit 47, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe mbështetur në këtë bazë ligjore AKBN-ja ka marrë vendimin, ku miraton projektin e mbylljes e për rrjedhojë fillimin e procedurave të revokimit të lejes nr.1814, datë 04.08.2016, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Gjergjovë”, Skrapar, Qarku Berat.

Sipas nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1814, datë 04.08.2016, të ndryshuar**, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Gjergjovë”, Skrapar, Qarku Berat, që shoqëria juaj zotëron.

Ju vëmë në dijeni se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit për mineral gur gëlqeror, në objektin “Gjergjovë” Skrapar, Qarku Berat.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitetet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI

ILIR BEJTIA

